



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal

Nr 8, datë 03.07.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e teatrit “Petro Marko”.  
Konstituimi i këshillit të bashkisë dhe deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të bashkisë( Ora 11<sup>10</sup>)

Marrin pjesë :

Deputetë; Prefekti i qarkut z.Flamur Mamaj; Kryetarët e bashkisë z.Dritan Leli dhe z.Ermal Dredha; Përfaqësues të besimeve fetare; Qytetarë.

Anëtarët e këshillit të bashkisë – 51 anëtarë(pjesëmarrje e plotë).

Hap mbledhjen z.Flamur Mamaj/Prefekti i Qarkut Vlorë .

Të nderuar deputetë!

I nderuar Kryetar i zgjedhur i bashkisë! Të nderuar këshilltarë!

Në këtë mbledhje të parë të konstituimit të këshillit, më lejoni t’iu uroj suksese këshilltarëve dhe kryetarit të bashkisë , zotit Ermal Dredha, mbas përfundimit të një procesi të suksesshëm zgjedhor.

Në përfundim të zgjedhjeve të datës 14 maj 2023 me Vendimin Nr 657, datë 07.06.2023, KQZ, “Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Vlorë, për zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023” , si dhe Vendimin Nr 647, datë 02.06.2023 “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të bashkisë, zotit Ermal Neki Dredha “ .

Mbas një procesi të suksesshëm dhe të qetë në të gjithë qarkun, janë respektuar afatet dhe tani po zhvillojmë ceremoninë e konstituimit të këshillit bashkiak dhe marrjen e detyrës së Kryetarit zotit Ermal Dredha, për vendimmarrje të drejta në të mirë të qytetarëve të Vlorës. Nga sot, kjo detyrë i kalon zotit Ermal Dredha, duke patur transparencë në zgjidhjen e problemeve..Prej sot këshilltarët fillojnë misionin e tyre në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.

Si përfaqësues i qeverisë, në qarkun e Vlorës, shpreh bindjen se me profesionalizmin tuaj , do të bëni detyrën me ndershmëri dhe transparencë..

Edhe njëherë, ju uroj punë të mbarë e suksese këshilltarëve dhe zotit Ermal Dredha. Urime!  
(Lexon Vendimin për shpërndarjen e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Vlorë, ardhur nga KQZ).

Prezentë 51 këshilltarë :

Subjekti;

Bashkë Fitojmë – 9 mandate

Partia Socialiste – 33 mandate

Partia Agrare Ambientaliste - 1 mandat

Partia Republikane – 1 mandat

Partia Demokracia Sociale – 1 mandat

Partia Demokratike – 3 mandate

Aleanca Progresiste LZHK – 1 mandat

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet – 2 mandate

Lexohet emër për emër, lista e anëtarëve të këshillit bashkiak, sipas subjekteve (Pjesëmarrja)

-Prezentë 51 anëtarë të këshillit:

-BF - 9 anëtarë

-PS - 33 anëtarë

-PAA -1 anëtar

-PR - 1anëtar


-PDS -1 anëtar

-PD - 3anëtarë

-AP.LZHK -1 anëtar

-PDIU - 2 anëtarë

Ftoj këshilltarin më të vjetër në moshë për të vazhduar më tej procedurat , z.Simo Petromilo.  
Ju uroj suksese dhe mbarësi në punën Tuaj!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 8/1, datë 03.07.2023

Z.Simo Petromilo – Të nderuar këshilltarë!

Faleminderit që më zgjodhët mua për vazhdimin e seancës së mbledhjes. Të gjithë këshilltarët janë prezentë.

Fillojmë me pikën 1 të rendit të ditës, me zgjedhjen dhe miratimin e komisionit të vërtetimit të mandateve.

Propozohet pa debate. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë. Komisioni i Mandateve do miratohet me shumicë votash. Bazuar në nenin 37 të ligjit Nr 139/2015 (Lexon ...për funksionin e anëtarëve të këshillit bashkiak .....Pas verifikimit të mandateve ....., kjo për Komisionin e Mandateve .

Kalojmë në propozimet për anëtarët e Komisionit të mandateve.

Z.Ervis Moçka – Meqenëse, komisioni bërëhet prej 5 anëtarësh , duhet një konsultim me grupin (kërkohet pushim)

Në emër të grupit propozoj, 3 anëtarë për komisionin , jo me 5 anëtarë .

Z.Simo Petromilo – Jeni dakort që komisioni të jetë me 3 anëtarë ?

Z.Ervis Moçka – Propozoj:

- 1.Klodian Xhyheri
- 2.Edison Kapaj
- 3.Frosina Qyrdeti

Z.Simo Petromilo – Në bazë të rregullores, komisioni duhet të jetë me 5 anëtarë. Deria tani janë propozuar 3.

Atëherë, e lëmë me 3 anëtarë ?

Votohet.

Propozohen dhe 2 anëtarë :

- 1.Eda Begaj
- 2.Grigor Dede

Pra komisioni, bazuar në propozimet e bëra, përbëhet nga 5 anëtarë.

Znj.Frosina Qyrdeti – Me cilësinë e kryetares së komisionit, pas mbledhjes së komisionit dhe verifikimit të mandateve, lexon procesverbalin e Komisionit të mandateve, i përbërë prej 5 anëtarësh...Lexon ..I mbajtur sot në datën 03.07.2023 , i përbërë nga anëtarët(emrat e anëtarëve të komisionit), vendosi zgjedhjen e kryesisë.(kryetar,sekretar,anëtar)

Marrin pjesë 51 anëtarë.

Të vlefshëm mandatet e 51 këshilltarëve. Vërtetohen mandatet.

Më pas ftohen këshilltarët të votojnë për procesverbalin e komisionit.

Faleminderit (Bashkëlidhur procesverbali i Komisionit të mandateve)

Z.Simo Petromilo – Dakort jeni me procesverbalin e Komisionit të Mandateve ?

Pro – 51 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .

Z.Simo Petromilo – Është koha më sublime, ku këshilltarët do të bëjnë betimin pranë

Kushtetutës. I pari kryetari i seancës dhe, me radhë gjithë këshilltarët.

Lexohet “ Formula e Betimit “ për anëtarët e këshillit bashkiakë.

Bëhet Betimi nga 51 anëtarë.

Z.Simo Petromilo – Suksese !



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 8/2, datë 03.07.2023

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, në zgjedhjen e kryetarit të këshillit .

Propozimet sipas spektrit.

Z.Ervis Moçka – Grupi i shumicës, propozon Znj.Elpinqi Mërkuri kandidate për kryetare të këshillit bashkiak.

Z.Simo Petromilo – Zonja Elpinqi. Jeni dakort të kandidoni për kryetare të këshillit bashkiak?

Znj.Elpinqi Mërkuri – Po, dakort.

Z.Simo Petromilo – Propozim tjetër, për kryetare të këshillit bashkiak ? Doni kohë për konsultim. Grupi i pakicës, ndonjë propozim tjetër ?

Z.Ervis Moçka – Mesa duket, s’paska propozim tjetër .

Z.Simo Petromilo – Nëqoftëse kërkoni kohë ....Atëherë votohet me 1 kandidat .

Z.Atird Hoxha – Jo, duhen 2 kandidatë.

Z.Ervis Moçka – Kalojmë tek komisioni zgjedhor.

Z.Simo Petromilo – Kalojmë në zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit, 3 anëtarë.

Z.Ervis Moçka – Propozoj për anëtarë të komisionit z.Vullnet Bilbilaj dhe znj.Briseida Çakërri.

Z.Simo Petromilo – A ka propozim tjetër ?

Atëherë ta hedhim në votë. Për 1 kandidat apo, për 2 ? Zoti Ervis, ndonjë propozim tjetër ?

Z.Ervis Moçka – Të lutem, kaloni tek anëtarët e komisionit të votimit, pasi me ligj nuk është për 2 kandidatë. Është një draft rregullore i bashkive të forta , miratuar në prill /2022....Pyet juristen e prefekturës...

Znj.Anxhela Shenaj – Propozoj znj.Briseida Çakërri.

Z.Simo Petromilo – Zonja Briseida, a pranoni të kandidoni për kryetare të këshillit bashkiak ?

Znj.Briseida Çakërri – Jo.

Z.Ervis Moçka - ...Propozoj , të hyjmë në votim me 1 kandidat.

Z.Simo Petromilo – E hedhim në votë. Kush do të dalim me 1 kandidat ?

Pro – Shumicë votash

Kundër –

Abstenim –

Z.Ervis Moçka – Propozoj për komisionin zgjedhor z.Vullnet Bilbilaj dhe znj.Briseida Çakërri, për ne.

Z.Ervis Moçka – E hedhim në votë, përbërjen e anëtarëve të komisionit të votimit. Propozoj 3 anëtarë për komision.

Z.Simo Petromilo – Kush është dakort që, komisioni të jetë me 3 vetë.

Z.Arjan Isufi – Kur ka vetëm një kandidaturë, pse duhet komisioni, çfarë do bëjnë...ajo e pranoi vetë kandidaturën.

Z. Gjergji Nika – Nnei 14 (lexon) ... e thotë pastër fare...

Z.Ervis Moçka – Pra, është një draft rregullore...e marrim të mirëqenë..Ky këshill ka fuqi ta ndryshojë dhe atë nen, me forcën e votës.

Z.Atird Hoxha - Rregulloren mund ta ndryshojmë sa herë mundet, sipas kërkesës ..

Z.Ervis Moçka - Nuk mund ta mbani peng..Propozimi është bërë. Ta votojmë me 1 kandidat.

Znj.Liljana Breshani – S’jemi dakort, asnjë nga ne nuk kandidon.

Z.Illir Aliaj – Ne e kemi bërë propozimin tonë. Po bëj një propozim tjetër, z.Myzafer Elezi.

Z.Simo Petromilo – Propozoni pa debat. Nuk mund të ngelet peng këshilli, që ju nuk keni bërë propozim. A ka propozim tjetër ?

Z.Arjan Isufi - Zoti Ilir , propozoi zotin Elezi. Bëni gati fletët e votimit dhe të fillojë votimi.

Z.Myzafer Elezi – Nuk jam dakort për kandidim.

Z.Ervis Moçka – Për komisionin e votimit , propozojmë zotin Vullnet dhe zonjën Briseida.

Znj.Rajmonda Zoto – Prpozoi zotin Besmir Brahimi .

Z.Simo Petromilo - Pra, komisioni i votimit, përbëhet nga :

1.Vullnet Bilbilaj

2.Briseida Çakërri

3.Besmir Brahimi .

Komisioni të zërë vendet.

Për komisionin e votimit për kryetare të këshillit të bashkisë, z.Vullnet Bilbilaj/kryetar;

Sekretar, zoti Besmir Brahimi

Anëtare, zonja Briseida Çakërri.

Z.Vullnet Bilbilaj – Sapo të jenë gati fletët e votimit, do të fillojë votimi, sipas rendit alfabetik ose subjektiv.

Fillojmë procesin e votimit, me subjektin

BF – 9

PS – 33

PAA – 1

PR – 1

PDS – 1

PD – 3

AP.LZHK -1

PDIU – 2

Përfundoi gjithë lista e votimit nga këshilltarët për zgjedhjen e kryetarit të këshillit bashkiak.

Fillon procesi i numërimit të votave.

Pro - 35 vota

Kundër – 2 vota

Abstenim – 2 vota( Lexon procesverbalin për kandidatin e vetëm 51 këshilltarë, 51 fletë votimi.

12 fletë të pavlefshme

2 kundër dhe 2 abstenim.

Miratohet me shumicë votash. Zonja Elpiniqi Mërkuri, zgjidhet Kryetare e këshillit bashkiak.

Zonja Elpiniqi Mërkuri, vazhdon më tej seancën e mbledhjes.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 8/3, datë 03.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Të nderuar deputetë, kolegë! I nderuar prefekt !  
Është nder dhe privilegj për mua që të jem në drejtimin e këtij këshilli, do tju lutesha anëtarëve të bëjnë debate konstruktive në të mirë të qytetit dhe qytetarëve të Vlorës. Në zgjedhjet e 14 majit 2023 , u zgjodh dhe fitoi alternativa më e mirë...(Bashkëlidhur fjala përshëndetëse e zonjës Mërkuri )

Vijojmë rendin e ditës me zgjedhjen e 2 zëvendëskryetarëve të këshillit të bashkisë. Ftoj të jepni propozimet dhe kandidaturat tuaja.

Z.Atird Hoxha – Suksese zonja kryetare! Edhe pse kjo procedurë nuk ishte e rregullt..., pati shumicë votash ,duke ju përmbajtur pikës 15 të nenit 15 të rregullores...,Pra duhen 2 zv/kryetarë. Bazuar në shkresën e KQZ, Bashkë Fitojmë, është koalicioni më i madh, propozoj zonjën Alta Haluci .

Z.Gjergji Nika - Propozoj zotin Myzafer Elezi, nga Partia Demokratike.

Z.Ervis Moçka – Si grupi i shumicës, propozoj zotin Novrus Rrokaj.

Z.Atird Hoxha – I qëndroj rregullores së këshillit bashkiak ,1 nga zv/kryetarët , i takon grupit opozitar më të madh në këshill. Propozimi i zotit Moçka, duhet të jetë i dyti. Pra, pasi të mbarojmë votimin për zonjën Alta ,nga grupi i opozitës, pastaj vazhdojmë me propozimin e zotit Moçka dhe propozimi i zotit Nika, nuk gjen vend .....

Z.Ervis Moçka – Për procedurë. Ka koalicion, nuk dimë kush është opozita më e madhe, prandaj, PD dhe BF të bëjnë një propozim.

Z.Atird Hoxha – Zonja kryetare. Duhet të lexoni shkresën e ardhur nga KQZ, ku përcaktohet në bazë të numrit se kush është partia më e madhe

Znj.Elpinqi Mërkuri – Bëhet votimi i propozimit nga partia më e madhe opozitare dhe propozimi i dytë nga grupi më i madh i shumicës.

Z.Ervis Moçka - Ftoj opozitën të dalë me një emër, ku përveç nenit 15 dhe nenit 14 i jep të drejtë grupit prej 5 këshilltarësh....

Z.Atird Hoxha - Ka të bëjë me të drejtën....Ne i kemi numrat për të bërë propozime. Neni 15 e thotë qartë , që i takon partisë më të madhe opozitare. Lexoni shkresën nga KQZ. Grupit më të madh opozitar i takon një kandidaturë. Të bëhet kjo procedurë dhe më vonë për zotin Rrokaj.



Z.Ervis Moçka - Jeni koalicion, jeni si opozitë.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Përderisa PD ka dalë me propozim për 1 anëtar, ti respektojmë.

Z.Ervis Moçka - Nuk i takon kryetares të thotë që kush është parta opozitare më e madhe. Shoh zotin Nika që po propozon.

Z.Arjan Isufi - Bazuar në shkresën e KQZ, BF është partia më e madhe opozitare.

Z.Myzafer Elezi - Bashkë Fitojmë është koalicion, jo parti. Partia më e madhe opozitare, është Partia Demokratike e Shqipërisë.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri - Vazhdojmë me votimin. Për ti dhënë mundësi gjithë partive, le të kalojmë në votim.

Z.Geron Gunbardhi – Unë jam bashkë me koalicionin, jam i Partisë Republikane. Me 1 kandidaturë kemi dalë.

Z.Ervis Moçka – Ne ju njohim si opozitë, pasi pjesa tjetër e opozitës ka dalë me emër të dytë.

Z.Atird Hoxha - Partia më e madhe opozitare sipas rregullores.

Z.Myzafer Elezi – Zonja kryetare, opozitën e përcakton vota. Partitë ndryshojnë nga koalicionet . Referojuni ligjit, i cili thotë për partitë politike dhe hidheni në votim.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri - Të përgatiten fletët e votimit, të hidhen në votim.

Z.Klodian Xhyheri - ...partisë më të madhe në këshill, përcaktohet...Grupi më i madh, është Bashkë Fitojmë.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri - Vazhdojmë me procedurën e votimit.

Z.Arjan Isufi – Vendimi nr 37/2022 i Këshillit të Bashkisë Vlorë, ...lexon “Për disa shtesa dhe ndryshime .....”,pra është rregullore.

Të respektojmë ligjin. Këtu jemi për Vlorën. Ligji jep përcaktime, bazohuni në ligje.

Në këshillin bashkiak do shkojmë me rregulla dhe ligje. KQZ ka miratuar një listë. Subjekti më i madh opozitar është Bashkë Fitojmë. S’kemi pse bëjmë lojra fjalësh.

Z.Illir Aliaj – Propozoni kandidaturën.

Z.Simbol Pazaj – Atë çpo kërkoni këtej përballë...t’ju japim kohë, të mblidheni të dy dhe propozoni 1 kandidat..Mos e kërkoni tek ne.

Z.Atird Hoxha – Edhe po të ndahen partitë, në këtë koalicion, është Partia e Lirisë që ka 5 këshilltarë,sipas rregullores...Forca e madhe opozitare jemi ne, kështu e thotë ligji.

Znj.Anxhela Shenaj – Zonja kryetare. Kush është partia më e madhe opozitare ?...Çfarë thotë ligji? Partia e Lirisë ka 5 anëtarë.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Po ju jap përgjigjen, Mund të kandidoni.

Z.Vullnet Bilbilaj - Mënyra si po e diskutoni, lë shumë për të dëshiruar. Le të vazhdojmë, gjejeni me qetësi midis jush dhe të vazhdojmë më tej procedurat.

Z.Ervis Moçka – Ju po i thoni kryetares së këshillit bashkiak, të gjejë partinë më të madhe. E keni me njëri tjetrin, një opozitë me dy kandidatë. Kryetarja nuk e përjashton dot propozimin e partisë tjetër.

Z.Atird Hoxha - Do të doja që, ju të udhëhiqeshit vetëm nga ligji dhe rregullorja. Pra, bazojuni

nenit 15 , pika 15.....lexon... 1 zv/kryetar i këshillit i takon partisë më të madhe opozitare..  
Z.Ervis Moçka – Neni 14 përcakton...(5 këshilltarë , propozojnë për zv/kryetar .Një zv/kryetar i takon opozitës.  
Pra, nuk mund të përcaktojë dot kryetarja e këshillit , kush është partia më e madhe opozitare  
Pesë minuta pushim dhe vendosni. Të bëhen gati fletët e votimit dhe fillojmë procesin e votimit.  
Znj.Elpiniqi Mërkuri - Fletët e votimit janë gati. Fillojmë procesin e votimit.  
Z.Vullnet Bilbilaj - Fillojmë procesin e votimit për 2 nënkryetarët e këshillit bashkiak.  
BF – 9 anëtarë  
PS – 33 anëtarë  
PAA – 1 anëtar  
PR – 1 anëtar  
PDS – 1 anëtar  
PD – 3 anëtarë  
AP.LZHK – 1 anëtar  
PDIU – 2 anëtar  
Mbasi mbaron procesi i votimit, vijon me procesin e numërimit të votave.  
Z.Vullnet Bilbilaj, lexon procesverbalin. (Bashkëlidhur materialit)  
Z.Novrus Rrokaj – 38 vota - Pro  
Z.Myzafer Elezi – 31 vota – Pro  
Znj.Alta Haluci – 17 vota – Pro  
Z.Novrus Rrokaj dhe z.Myzafer Elezi , zgjidhen 2 nënkryetarët e këshillit të bashkisë .  
Miratohet.  
Suksese!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 8/4, datë 03.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën tjetër, në deklarin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të bashkisë. Lexon, Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë “Për vlefshmërinë e mandatit të Kryetarit të Bashkisë z.Ermal Dredha, Vendim Nr 426 , datë 12.06.2023...Vërtetimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, për Zgjedhjet për Organet e Vetqeverisjes Vendore të zhvilluara në datë 14 maj 2023.

Ftojme Kryetarin e Bashkisë z.Ermal Dredha.

Lexohet Formula e Betimit të Kryetarit të Bashkisë.

Z.Ermal Dredha - Beto hem.

Bën betimin z.Ermal Dredha, Kryetari i Bashkisë.

Z.Ermal Dredha - Përs hëndetje të gjithëve !

Faleminderit për gjithë angazhimin tuaj. Ju uroj, si fillim, suksese të gjithëve. Do të kemi bashkëpunim së bashku .....

Të nderuar autoritete prezentë në sallë! T w nderuar deputetë !

Të dashur qytetarë vlonjatë!

Falënderoj Kryeministrin, zotin Edi Rama për mundësinë dhe besimin e dhënë dhe qytetarët vlonjatë që me votën e tyre më besuan drejtimin e qytetit, këtë mandat-4 vjeçar.

Këshilli bashkiak është përfaqësimi i gjithë vlonjatëve në institucion...

Punë të mbarë kryetares së këshillit të bashkisë.

Do të jem kryetari i gjithë vlonjatëve, pa dallime partiake, ku dera e bashkisë do të jetë gjithmonë e hapur për këdo.

Nga sot do të fillojmë punën për ta bërë Vlorën , një qytet të pastër e të zhvilluar ekonomikisht.

Pastrimi, turizmi, punësimi, do të jenë disa nga prioritetet e punës tonë.

Vetëm me frymë bashkëpunimi dhe besimi reciprok, do të arrijmë të bëjmë punë të mira së bashku. Dera e bashkisë do të jetë hapur. Shqetësimi juaj do të jetë shqetësimi im dhe i administratës. Jam sy e vesh për një bashkëpunim , me qëllim që Vlora të eci përpara.

Punë të mbarë dhe faleminderit ! (Bashkëlidhur fjala përs hëndetje e Kryetarit z.Ermal Dredha )



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 8/5, datë 03.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri -Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me zgjedhjen e këshilltarëve , që do të përfaqësojnë këshillin e bashkisë në këshillin e qarkut.

Lexon shkresën e Prefektit të Qarkut Vlorë për numrin e përfaqësuesve të këshillit të bashkisë në këshillin e qarkut.....Në zbatim të Kodit Zgjedhor, neni 8, pika 1 i ligjit Nr 139/2015., prefekti, informon se, është përcaktuar numri i anëtarëve të Këshillit të qarkut , bazuar në numrin e popullsisë...Pra, është 8 numri i anëtarëve të Këshillit të qarkut;

- 7+1 Kryetari i bashkisë.

Presim propozimet tuaja.

Z.Ervis Moçka - Propozoj 4 gra dhe 4 burra , 1 është Kryetari i bashkisë. Pra ;

1. Znj.Liljana Breshani
- 2.Znj.Evis Allushi
- 3.Znj.Englantina Imeraj
- 4.Znj.Anisa Ceno **dhe;**

- 1.Z.Ervis Moçka
- 2.Z.Gëzim Çapoj
- 3.Z.Besmir Brahimi

Z.Atird Hoxha – Propozoj:

- 1.Z. Arsen Belaj
- 2.Z.Geron Gunbardhi
- 3.Znj.Liri Dëma

Znj.Elpinqi Mërkuri – Një propozim tjetër , për një anëtar të komisionit të votimit, të zëvendësohet zoti Besmir Brahimi .

Propozohet zonja Eda Begaj .

Votohet. Të gjithë dakort.

Pra , komisioni i votimit i përbërë nga:

- 1.Vullnet Bilbilaj
- 2.Briseida Çakërri
- 3.Eda Begaj (zëvendësohet z.Besmir Brahimi )

Z.Vullnet Bilbilaj – Fillojmë procesin e votimit. Para se të votojmë , ju bëj me dije se, lista ka 10 anëtarë dhe do të votohet për 7 anëtarë.

Mbas përfundimit të votimit , rezultoi se;

- 1.Znj.Liljana Breshani – 31 vota
  - 2.Znj.Evis Allushi – 35 vota
  - 3.Znj.Englantina Imeraj – 35 vota
  - 4.Znj.Anisa Ceno – 35 vota
  - 5.Z.Besmir Brahimi – 31 vota
  - 6.Z.Gëzim Çapoj – 36 vota
  - 7.Z.Ervis Moçka – 37 vota
- Z.Arsen Belaj – 17 vota  
Z.Geron Gunbardhi – 15 vota  
Znj.Liri Dëma – 15 vota.

Nga 51 fletë votimi, 2 fletë janë të pavlefshme.

Pra, 7 të parët, janë anëtarët e rinj të Këshillit të Qarkut

Znj.Elpinqi Mërkuri – Para se të mbyllim seancën, njëri nga zv/kryetarët do të bëjë një përshëndetje. Suksese.

Z.Myzafer Elezi – Faleminderit për votën që më dhatë. Jam i bindur se edhe pse vij nga spektri i djathtë, jam i bindur se, qëllimi është i përbashkët. Një përshëndetje për gjithë demokratët dhe familjen time.